

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANEL NO: 1

NR I VENDIMIT.: KPCC/D/A/155/2012
DATA E VENDIMIT: 06/06/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 35 (tridhjetë e pesë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(2) Në secilën prej 35 (tridhjetë e pesë) kërkesave të referuara në paragrafin (1) më sipër, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.

(3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe

- (4) *Më rastet kur ka më shumë se një pronar urdhrat dhe vendimet e mësipërme nuk ndikojnë në të drejtat bashkëpronarëve respektive.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50,

lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e nëntë nga 4 deri 6 qershor 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 1601 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e nëntë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Gjithsej nëntë kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit u kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni gjatë seancës dhe katër kërkesa për pronë bujqësore të cilat i ishin paraqitur Komisionit u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e dy kërkesave për pronë bujqësore të cilat i janë paraqitur kësaj seancë, në pritje të mbajtjes të seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi 6 kërkesa të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 1592 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 35 kërkesa të identifikuar në listën e bashkangjitur. Kërkesat nr. 00657, 00663, 15206 dhe 50216 kanë qenë subjekt i një vendimi² të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimet e mëparshme në këto kërkesa janë shfuqizuar nga Komisioni ose për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit i parashihet që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksat e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

² Kërkesa nr. 00657 është vendosur nga KPCC/D/A/25/2008 datë 23 tetor 2008, Kërkesa nr. 00663 është vendosur nga KPCC/D/A/19/2008 datë 20 qershor 2008, Kërkesa nr. 15206 është vendosur nga KPCC/D/A/2/2007 datë 3 shtator 2007 dhe kërkesa nr. 50216 është vendosur nga by KPCC/D/A/42/2009 datë 19 qershor 2009.

transaksioni ligjor. Pjesa e mbetur prej 1,557 kërkesave për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera KPCC/D/A/154/2012 dhe vendimin KPCC/D/A/156/2012.

9. Të 35 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë

11. Në katër kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në këtë pronë ("Pala përgjegjëse") ose nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka kërkuar të ketë lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën pa ofruar ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

a. Kërkesa nr. 01142

12. Në kërkesën nr. 01142, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht gjyshes së tij të ndjerë. Në mbështetje të kërkesës së tij ka paraqitur fletën poseduese në emër të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë.

13. Pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën duke pretenduar se e kishte blerë pronën e kërkuar rreth 2002-2003 nga një pale e tretë, i cili sipas palës përgjegjëse e kishte blerë pronën më herët nga babai i mbajtësit të së drejtës pronësore. Megjithatë pala përgjegjëse dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës e mohoi faktin që mbajtësi i së drejtës pronësore e kishte shitur pronën e kërkuar.

b. Kërkesa nr. 23051

14. Në kërkesën nr. 23051, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin e trashëgimisë dhe një fletë poseduese që e tregon atë si bashkëpronar të pronës së kërkuar. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

15. Prona e kërkuar është notifikuar fillimisht pasaktësisht dhe prona e notifikuar pasaktësisht u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse i cili e kundërshtoi kërkesën në

lidhje me këtë pronë. Pala përgjegjëse nuk e ka tërhequr kundërshtimin pas notifikimit të dytë të saktë të pronës së kërkuar dhe deklaroi se dëshiron ta blejë pronën e kërkuar.

c. Kërkesat nr. 50442 dhe 92429

16. Kërkesa nr. 50442 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht si bashkëpronar i pronës së kërkuar. Kërkesa nr. 92429 është depozituar nga i njëjti paraqitës i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht vëllait të saj. Të dy kërkesat lidhen me të njëjtën pronë. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex-officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme e cila e tregon paraqitësin e kërkesës dhe vëllain e saj si bashkëpronar të pronës së kërkuar.

17. Pala përgjegjëse për të dy kërkesat, po i shfrytëzon aktualisht pronat dhe pretendon se ka rënë dakord me paraqitësin e kërkesës për çmimin e blerjes së pronës, megjithatë ai pranon se kontrata nuk është nënshkruar asnjëherë, nuk është kryer asnjë transaksion e nuk janë paguar as të hollat.

2. Kërkesa kontestuese – të tjera

18. Në të 31 kërkesat e identifikuara në pjesën B të listës së bashkangjitur, pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara, ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë Komisioni ka arritur në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen për arsyet e përmendura më poshtme.

a. Kërkesat nr. 00657, 00663, 50211, 50215, 50216, 90300 dhe 90301

19. Kërkesat nr. 00657 dhe 00663 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës Damjan Ristic (“Paraqitësi i parë i kërkesës”) në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëpronar i pronave. Kërkesat nr. 50211, 50215, 50216, 90300 dhe 90301 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës Stojan Ristic (“Paraqitësi i dytë i kërkesës”) si anëtar i bashkësisë familjare i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë Dusan Ristic. Kërkesat kanë të bëjnë me të njëjtat prona. Paraqitësi i parë i kërkesës është xhaxhai/daja i paraqitësit të dytë të kërkesës dhe vëllai i të ndjerit Dusan Ristic. Sekretaria Ekzekutive i konstatoi të dy paraqitësit e kërkesës si bashkëpronarë të pronave të kërkuara në regjistrat kadastralë, me përjashtim të pronës së kërkuar në kërkesën nr. 50211, për të cilën regjistrat nuk janë përditësuar ende në emër të paraqitësit të dytë të kërkesës për pjesën e tij si bashkëpronar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar vendimin e trashëgimisë datë 20 maj 2002, paraqitur nga paraqitësi i dytë i kërkesës, si të vërtetë. Sipas vendimit, Paraqitësi i dytë i kërkesës e ka trashëguar pronën nga babai i tij i ndjerë. Paraqitësit e kërkesave e kanë humbur posedimin e pronave të kërkuara në vitin 1999 si rezultat i konfliktit. Komisioni konstaton se paraqitësit e kërkesave kanë demonstruar dëshmi të mjaftueshme se ata janë bashkëpronarë të pronave të kërkuara dhe e kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit.

20. Pala përgjegjëse pohon se pronat e kërkuara kanë qenë në pronësi të familjes së tij dhe ishin shpronësuar në fund të Luftës së Parë Botërore. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për të vendosur rreth çështjeve të shpronësimit që kanë ndodhur para dhe nuk kanë lidhje me konfliktin. Rrjedhimisht, pala përgjegjëse ka dështuar të dëshmojë mbrojtje të vlefshme.

b. Kërkesa nr. 00706

21. Në kërkesën nr. 00706, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së saj, paraqitësi i kërkesës paraqiti kontratën e dhurimit përmes secilës ajo ka marrë si dhuratë një pjesë së pronës së kërkuar nga vëllai i saj. Kontrata është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

22. Pala përgjegjëse pretendon se prona e kërkuar i takon paraardhësve të tij dhe është shpronësuar pas vitit 1922. Më pas prona i është dhënë familjes së paraqitësit të kërkesës. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për të vendosur rreth çështjeve të shpronësimit që kanë ndodhur para dhe nuk kanë lidhje me konfliktin. [Komisioni konstaton se vlerësimi i vlefshmërisë së mbrojtjes nuk është në mandatin e Komisionit. Për rrjedhojë, Pala përgjegjëse dështoi të dëshmojë mbrojtje të vlefshme.

c. Kërkesat nr. 15206, 19393 dhe 19399

23. Kërkesat nr. 19393 dhe 19399 janë depozituar nga by Zorka Davidovic (the "Paraqitësi i parë i kërkesës") në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëpronarit të pronës së kërkuar. Kërkesa nr. 15206 është depozituar nga Vukosava Stanisic ("Paraqitësja e dytë e kërkesës") në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëpronarit. Kërkesat nr. 15206 dhe 19393 ndërlidhen me të njëjtën pronë. Paraqitësit e kërkesës paraqitën fletët poseduese të cilat tregojnë se pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të të dy paraqitësve të kërkesës si bashkëpronarë. Dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, i thjeshtri i paraqitësit të parë të kërkesës dhe vajza e paraqitësit të dytë të kërkesës të dy deklaruan se pronat nuk ishin shitur.

24. Pala përgjegjëse e kërkesës nr. 15206 dhe 19393, e cila po shfrytëzon aktualisht pronat e kërkuara, pretendon se prona e kërkuar është shpronësuar nga ai prej një kohe shumë të gjatë. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për të vendosur rreth çështjeve të shpronësimit që kanë ndodhur para dhe nuk kanë lidhje me konfliktin. Rrjedhimisht, pala përgjegjëse dështoi të dëshmojë mbrojtje të vlefshme.

25. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 19399 pretendon se një kombinat bujqësor në pronësi shoqërore i ka marrë babait të tij pronën e kërkuar në vitin 1953. Ai ka paraqitur një fletë të vjetër poseduese, një vendim administrative dhe një certifikatë që i tregonte parcelat me numra dhe sipërfaqe të ndryshme të cilat nuk lidhen me pronën e kërkuar. Më tej pala përgjegjëse pretendon se ka paraqitur një padi në Gjykatën Komunale të Ferizajt në lidhje me të gjitha pronat që pretendon se i janë marrë familjes së tij, megjithatë ai dështoi të paraqesë dëshmi të kësaj padie, pasi iu kërkuar të vepronte kështu nga Sekretaria Ekzekutive.

d. Kërkesa nr. 37058, 37059 dhe 37060

26. Në kërkesat nr. 37058, 37059 dhe 37060 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesat në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese që e tregon atë si pronar të pronave të kërkuara. Ky dokument është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës deklaroi gjithashtu se pronat nuk janë shitur.

27. Pala përgjegjëse, i cila ka uzurpuar pronat e kërkuara, i konteston kërkesat dhe pretendon se gjyshi i tij i ka blerë pronat në vitin 1929 nga një palë e tretë. Ai pretendon

gjithashtu se gjyshi i tij është detyruar nga autoritetet në vitin 1941 që të blejë të njëjtën pronë nga gjyshi i paraqitësit të kërkesës, por transferimi i pronësisë nuk është bërë asnjëherë. Pala përgjegjëse pretendon se ka depozituar padi kundër paraqitësit të kërkesës në vitin 2007 në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi të rëndësishme në mbështetje të pohimeve të tij.

e. Kërkesat nr. 00374, 23332 dhe 23333

28. Kërkesa nr. 00374 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Kërkesat nr. 23332 dhe 23333 janë bërë nga një paraqitës tjetër i kërkesave në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj të ndjerë. Kërkesa nr. 00374 ndërlihet me të njëjtën pronë që kërkohet në kërkesat nr. 23332 dhe 23333. Të dy paraqitësit e kërkesave paraqitën *inter alia* një fletë poseduese e cila i tregon pronat e kërkuara në emër të babait të tyre të ndjerë. Dokumenti është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

29. Pala përgjegjëse i kundërshtoi kërkesat duke pretenduar se i kishte blerë pronat e kërkuara por dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pohimeve të saj.

f. Kërkesa nr. 34561

30. Në kërkesën nr. 34561, paraqitësi i kërkesës ka depozituar fillimisht kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Ndërkohë paraqitësi i kërkesës ka ndërruar jetë dhe kur Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi djalin e paraqitësit të kërkesës, ai informoi se e kishte trashëguar pronën e kërkuar dhe se ekziston edhe një vendim i trashëgimisë dhe një vendim i ndarjes së pronës të cilat i ka paraqitur. Prona e kërkuar ishte regjistruar tashmë në regjistrat kadastralë në emër të djalit të paraqitësit të kërkesës bazuar në dokumentet e lartpërmendura. Djali i paraqitësit të kërkesës deklaroi gjithashtu se pronat nuk janë shitur. Komisioni konstaton se djali i paraqitësit të kërkesës ka demonstruar dëshmi të mjaftueshme se ai është pronari aktual i pronave të kërkuara.

31. Pala përgjegjëse pretendon se pronat e kërkuara i kanë takuar gjyshit të saj por që e kanë shpronësuar edhe ia kanë dhënë familjes së paraqitësit të kërkesës. Ajo deklaroi më tej se nëna e saj ka bërë padi në Gjykatën Komunale të Deçanit dhe se rasti është në pritje për t'u vendosur. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi përkatëse në mbështetje të pohimeve të saj. Kur u pyet nga Sekretaria Ekzekutive nëse ajo kërkonte të drejtë ligjore për pronat e kërkuara në këtë kërkesë, ajo informoi të kontaktohej avokati i saj. Kur Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi avokatin e palës përgjegjëse ai pohoi se familja e palës përgjegjëse nuk e kundërshton më kërkesën.

g. Kërkesat nr. 07492, 07501 dhe 07512

32. Në kërkesat nr. 07492, 07501 dhe 07512, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës paraqiti *inter alia* një kontratë të përkujdesjes jetësore të vitit 1993 mbi bazën e secilës nëna e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore ia dha pronën mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të saj. Sipas kontratës, mbajtësi u së drejtës pronësore u bë pronar i pronave të kërkuara në kërkesën nr. 07492 dhe 07501, dhe bashkëpronar i pronës së kërkuar në kërkesën nr. 07512, pasi vjehrra e saj ndërroi. Pronat e kërkuara janë të regjistruara në regjistrat kadastralë në emër të babait të mbajtësit të pretenduar të së

drejtës pronësore. Megjithatë ky regjistrim i pasaktë është korrigjuar me anë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtri me anë të secilit nëna e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore është konfirmuar si pronare me të drejta të plota e pronave të kërkuara. Kështu kontrata e lartpërmendur e përkujdesjes jetësore është e vlefshme. Kjo mbështetet me tej me një vendim të Gjykatës Komunale në Vushtri të vitit 2005 me anë të të cilit procedura e trashëgimisë për nënën e ndjerë është pezulluar pasi ajo e kishte tjetërsuar pronën gjatë kohës që ishte gjallë përmes kontratës së përkujdesjes jetësore.

33. Pala përgjegjëse pretendon se ai ka pëlqimin e mbajtësit të së drejtës pronësore për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se mbajtësi i së drejtës pronësore i kishte dhënë lejë palës përgjegjëse për të shfrytëzuar pronat e kërkuara por se kjo lejë ishte ndërprerë pasi pala përgjegjëse kishte dështuar të përmbushtë kushtet për të cilat ishin pajtuar. Pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pohimeve të tij.

h. Kërkesa nr. 08846

34. Në kërkesën nr. 08846, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti kontratën e dhurimit të vitit 1997, të lidhur midis tij edhe babait të tij. Vëllai i paraqitësit të kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë në lidhje me të njëjtën prone në kërkesën nr. 11256. Ai pretendon gjithashtu se e ka përfutur pronësinë për pronën e kërkuar përmes kontratës së dhurimit e lidhur midis paraqitësit të kërkesës dhe babait të tij. Kontrata e dhurimit e lidhur midis paraqitësit të kërkesës në kërkesën nr. 08846 dhe babait të tij është lidhur afërsisht katër muaj para se të lidhej kontrata e dytë e dhurimit midis vëllait dhe babait të tij. Pasi nuk ka dëshmi që sugjeron se transaksioni i pare i pronësisë nuk ishte i vlefshëm, babai nuk ka mundur të tjetërsojë në mënyrë të vlefshme për herë të dytë pronën. Për rrjedhojë, Komisioni arrin në përfundimin se kërkesa nr. 08846 duhet të miratohet në emër të paraqitësit të kërkesës. Kërkesa nr. 11256 është vendosur me vendimin KPCC/D/A/156/2012.

i. Kërkesa nr. 35239

35. Në kërkesën nr. 35239, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë fillimisht në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Megjithatë, certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme date 14 maj 2008, e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës e tregon paraqitësin e kërkesës si bashkëpronar të 3/9 të pronës së kërkuar. Dokumenti është përditësuar në favor të paraqitësit të kërkesës më 21 maj 2007. Paraqitësi i kërkesës shpjegon se ai e ka trashëguar pronën nga babai i tij. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar si të vërtetë certifikatën.

36. Pala përgjegjëse e kundërshton kërkesën duke pretenduar se ai e ka blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2002. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të provojë pretendimet e tij ose të paraqitë ndonjë dëshmi në mbështetje të tyre.

j. Kërkesat nr. 39586, 39591, 39592, 39596 dhe 39601

37. Në kërkesat nr. 39586, 39591, 39592, 39596 dhe 39601, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Kushëriri i paraqitësit të kërkesës pretendon të jetë pronar i pronave të njëjta dhe ka depozituar kërkesa konkurruese me kërkesat nr. 36006, 36012, 36015, 36017 dhe 36019. Këto kërkesa janë

trajtuar nga Komisioni në vendimin KPCC/D/A/156/2012. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ajo është pronare e pronave të kërkuara në bazë të kontratës së përkujdesjes jetësore të vitit 1984 të lidhur mes babait të saj si përfitues i kujdesit dhe dhurues i pronave dhe paraqitësit të kërkesës si ofrues i kujdesit dhe përfitues i pronave. Sipas kontratës paraqitësi i kërkesës do të bëhet pronar i pronave pas vdekjes së babait. Sekretaria Ekzekutive i kërkoi paraqitësit të kërkesës të ofrojë certifikatën e vdekjes për të vërtetuar se babai ka vdekur, megjithatë kjo nuk është ofruar nga paraqitësi i kërkesës. Kur Sekretaria Ekzekutive u përpoq të kontaktojë paraqitësin e kërkesës përsëri, bashkëshorti i paraqitëses së kërkesës deklaroi se ata ishin shkurorëzuar dhe se paraqitësi i kërkesës kishte ndërruar jetë. Pronat e kërkuara janë të regjistruara në regjistrat kadastralë në emër të babait të paraqitësit të kërkesës. Pasi nuk ka dëshmi të dokumentuar se babai i paraqitësit të kërkesës ka ndërruar jetë, Komisioni konsideron se kërkesa duhet të miratohet në emër të babait të paraqitësit të kërkesës.

k. Kërkesa nr. 48156

38. Në kërkesën. 48156, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht si bashkëpronar i pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës së tij ai ka paraqitur fletën poseduese e cila e tregon atë si bashkëpronar të pronës. Dokumenti është verifikuar se i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

39. Pala përgjegjëse e konteston kërkesën duke pretenduar se prona e kërkuar ka qenë pronë e gjyshit të tij edhe i është shpronësuar atij shumë kohë më parë. Pala përgjegjëse pretendon se po pret që t'i vijnë dokumentet nga Turqia për të dëshmuar pretendimet e tij, megjithatë, ai dështoi të paraqitë këto dokumentet. Komisioni vëren se nuk ka juridiksion për të vendosur rreth çështjeve të shpronësimit që kanë ndodhur para dhe nuk kanë lidhje me konfliktin. Kështu, pala përgjegjëse ka dështuar të dëshmojë një mbrojtje të vlefshme.

l. Kërkesat nr. 28995 dhe 28996

40. Në kërkesat nr. 28995 dhe 28996, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht si bashkëpronar i pronave të kërkuara. Në mbështetje të kërkesave të saj, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* fletën poseduese që e tregon atë si bashkëpronar të pronave të kërkuara dhe një vendim trashëgimie në bazë të të cilit ajo ka trashëguar pronat e kërkuara nga babai i saj. Të dy dokumentet janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

41. Pala përgjegjëse, i cili ka uzurpuar aktualisht pronat, i konteston kërkesat duke pretenduar se i ka blerë pronat në vitin 1991 nga babai i paraqitësit të kërkesës dhe se ka ndërtuar shtëpi mbi atë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala përgjegjëse ka paraqitur *inter alia* një kontratë blerje informale të vitit 1991, disa dëshmi të dëshmitarëve dhe një letër nga avokati i tij që deklaron se pala përgjegjëse ka bërë padi në vitin 2009 në gjykatën kompetente vendore për konfirmimin e të drejtave të tij pronësore. Komisioni vëren se kontrata e blerjes nuk ndërlidhet me pronat e kërkuara në kërkesat nr. 28995 dhe 28996, por me një prone të kërkuar në një kërkesë tjetër. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, përfaqësuesi i autorizuar i palës përgjegjëse pretendoi se pala përgjegjëse ka blerë një prone tjetër përmes kontratës në fjalë por se pala përgjegjëse ka blerë gjithashtu pronat e kërkuara menjëherë pasi kjo kontratë ishte lidhur. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kopje të kontratës së blerjes të lidhur midis babait të saj si shitës dhe babait të palës përgjegjëse si blerës e cila tregon se ishin shitur prona të tjera por se prona e kërkuar nuk ishte shitur mes tyre.

42. Gjatë seancës së 28-të më 19 prill 2012, Komisioni urdhëroi mbajtjen e seancës dëgjimore nga një prej anëtarëve të tij në pajtim me nenin 5.4 të Aneksit III të Rregullores së UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 për të dëgjuar në këtë rast palët dhe dëshmitarët e palës përgjegjëse. U paraqitën pala përgjegjëse dhe tri dëshmitarët për seancën dëgjimore të datës 24 maj 2012 në zyrat e KPA-së në Prishtinë. Paraqitësi i kërkesës nuk ishte i pranishëm në seancë pasi Sekretaria Ekzekutive nuk pati mundësi ta kontaktojë e ta ftojë në seancë. Në seancë, pala përgjegjëse pretendoi se bashkëshorti i saj i ndjerë kishte blerë një cope tokë në vitin 1991 nga babai i paraqitësit të kërkesës, e cila përbehej nga me tepër se 24 ari dhe se ai kishte paguar çmimin prej 3,700 DM për pronën. Pala përgjegjëse, deklaroi më tej se ishte bërë një marrëveshje informale pasi transaksionet ndëretnike të pronës së paluajtshme nuk lejoheshin në ligjin në fuqi në atë kohë. Në vitin 1992, bashkëshorti i palës përgjegjëse filloi të ndërtojë një shtëpi në pronë; shtëpinë në të cilën ajo banon edhe sot. Të tri dëshmitarët deklaruan se bashkëshorti i palës përgjegjëse e kishte blerë token nga babai i paraqitësit të kërkesës dhe një nga dëshmitarët deklaroi se ai ishte i pranishëm kur u lidh kontrata e kur u paguan të hollat.

43. Komisioni konsideron se deklaratat dhe dëshmitë e palës përgjegjëse ishin koherente dhe ndërlidhen me pronën që është subjekt i marrëveshjes informale kontestuese të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse. Megjithatë, këto deklaratat dhe dëshmi nuk ndërlidhen me pronat e kërkuara në kërkesat nr. 28995 dhe 28996. Kështu, bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen në emër të paraqitësit të kërkesës.

44. Nga sa u tha më sipër, bazuar në dëshmitë që i posedon, Komisioni konstaton se në kërkesat e identifikuar ne pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999

45. Rrjedhimisht, pasi paraqitësit e kërkesave në secilën nga kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur kanë dëshmuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palës përgjegjëse të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

B. Kërkesa për kompensim


46. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat të përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

C. Vërejtje përmbledhëse

47. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

48. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

49. Vendimi i Komisionit nuk paragjykon të drejtën e paraqitësve të kërkesës ose mbajtësve të së drejtës pronësore sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e te drejtave të tyre pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoritetet kadastrale apo gjykatat vendore, në përputhje me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA01142
KPA23051
KPA50442
KPA92429

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA00657	KPA00663	KPA00706	KPA15206	KPA19393	KPA19399	KPA37058
KPA37059	KPA37060	KPA50211	KPA50215	KPA50216	KPA90300	KPA90301
KPA00374	KPA23332	KPA23333	KPA34561	KPA07492	KPA07501	KPA07512
KPA08846	KPA35239	KPA39586	KPA39591	KPA39592	KPA39596	KPA39601
KPA48156	KPA28995	KPA28996				